



ALUMNËT

nga pjesëmarrja tek
monitorimi i reformave

ASP

PROGRAM I RI MBËSHTETJEJE PËR RRRITJEN E KAPACITETEVE TË ALUMNËVE NË FUSHËN E KËRKIMIT DHE ADVOKIMIT

Nga pjesëmarrja tek monitorimi i reformave

Angazhimi profesional dhe qytetar i alumneve si promotorë të ndryshimit dhe të zbatimit të reformave të rëndësishme integruese në vend, është i nevojshëm që të shoqërohet edhe më zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të tyre në fushën kërkimore dhe advokuese. Me këtë synim, Akademia e Studimeve Politike në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), ideuan në vitin 2016 një program të ri dedikuar alumneve të shkollës duke mbështetur aktivitete kërkimore dhe advokuese me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor. Punimet u fokusuan në këtë fushë për shkak të vëmendjes që i është kushtuar nga programi i Shkollës rritjes së qeverisjes dhe demokracisë vendore si dhe reformës administrativo-territoriale, e cila ka sjellë kompetenca dhe sfida të reja për pushtetin vendor dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Pas një procesi të hapur aplikimi në muajin maj për të gjithë pjesëtarët e rrjetit alumni, u përzgjedhën pesë propozimet më të mira të alumneve. Në muajt në

vijim, alumnet përfituan dy trajnime mbi teknikat e kërkimit dhe shkrimit të punimit kërkimor si dhe advokimit. Gjithash-tu një mbështetje financiare u vendos në dispozicion të tyre për të zhvilluar kërkimin dhe monitorimin në terren të tematikave të propozuara. Mentorimi i punimeve iu besua znj. Sashenka Lleshaj, e cila ndihmoi me eksperiencën e saj në çdo hap të punimeve.

Më konkretisht punimet kërkimore u fokusuan:

- Evidentimin e shembullit pozitiv të bashkisë Korçë për punësimin e personave “të dënuar në shërbim prove” dhe “ish të dënuar”;
- Monitorimin e situatës së transferimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore në Bashkinë Tiranë pas reformës administrative-territoriale;
- Vlerësimin e mënyrave për të përfshirë komunitetet rurale bregdetare në administrimin e plazheve të Rivierës Shqiptare;



- Monitorimi i standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ndërhyrjet infrastrukturale të vitit 2015-2016 të Bashkisë Tiranë;

REKOMANDIMET KRYESORE TE PUNIMEVE



Monitorimi i standardeve të 20 investimeve infrastrukturore në bashkinë Tiranë
- Autore znj. Suela Lala

1. Të sigurohet informacion dhe trajnim mbi standardet e aksesueshmërisë për stafin përkatës në bashki, në kompanitë projektuese, si dhe në kompanitë e kontraktuara që do të kryejnë punimet.

2. Të sigurohet shqyrtimi i aksesueshmërisë për të gjitha ndërhyrjet.

3. Të krijohet një mekanizëm ankesash i lehtë në përdorim për personat me aftësi të kufizuara për të adresuar problemet e aksesueshmërisë në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës.



Riintegrimi i personave ish-të dënuar dhe në shërbim prove
- Autore znj. Evis Fico

1. Propozim për ngritjen e një databaze unike (regjistër kombëtar të dhënash për kategorinë në fjalë) që do t'u vijë në ndihmë institucioneve që merren me trajtimin e kësaj kategorie.

2. Realizimi i një plani pilot për mënyrën



Konferenca Kombëtare për prezantimin e punimeve kërkimore të alumnëve

vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, punimet e alumnëve tentuan që të evidentojnë shembujt pozitivë në bashki të caktuara si dhe ofrimin e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e praktikave të hasura në vitin e parë të zbatimit të reformës.

Këto punime të alumnëve u prezantuan në një konferencë, e cila mbledhi së bashku në Tiranë vendimmarrës, politikëbërës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Punimet u vlerësuan nga aktorët e ndryshëm të ftuar në këtë event si një angazhim i duhur i profesionistëve dhe qytetarëve aktivë për të përmirësuar problematikat që shfaqen dhe ndikojnë në mirëqeverisjen vendore. Diskutimi i gjetjeve të këtyre punimeve kishte për qëllim publikimin e rekomandimeve dhe shembujve pozitivë në bashkitë e studiuara si dhe njohjen nga publiku i gjerë. Dokumentat u shpërndanë gjithashtu nëpërmjet kanaleve të komunikimit të Akademisë me aktorët kryesorë si dhe antarët e tjerë të rrjetit alumni. Pas kësaj eksperience pozitive dhe interesimit të treguar nga alumnët është programuar që të hapet një thirrje e ngjashme për kërkime dhe mbështetje financiare përkatëse edhe në vitin 2017.

Skani kodin QR për të lexuar punimet e plota



Bashkinë Tiranë si dhe njësitet e tjera vendore nga ky detyrim.

2. Rekomandohet ngritja e një databaze të integruar të dhënash mbi pasuritë e paluajtshme, përmes aplikimit të një sistemi informacioni GIS dhe një sistemi të menaxhimit financiar, ku të identifikohen të gjitha pasuritë e paluajtshme të administruara nga bashkia Tiranë.

- Monitorimin e procedurave të prokurimit publik në bashkinë Kamëz dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor.

Në muajt në vijim alumnët e përfshirë

në këtë program patën mundësi që të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore risitë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrative-teritoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe

e asistimit të personave që kanë kryer dënimin apo kryejnë një dënim alternativ përmes planeve individuale të veprimit duke përfshirë çdo shërbim.

3. Sugjerohet hartimi i një mase aktive për përfshirjen sociale të të dënuarve si: masa në komunitet, shërbime komunitare, ndërmjetësim, veçanërisht për personat të cilët nuk kanë kapacitetin e duhur për të gjetur një vend pune, strehim etj.



Transferimi i pronës publike tek Njësitet Vendore - Autor z. Arlind Lugji

1. Paraqitet një nevojë urgjente për ndërhyrje lidhur me kostot e regjistrimit të pronave (700 lek), Për bashkinë Tiranë kostot e regjistrimit përbëjnë rreth 1% të të ardhurave vjetore. Duke qenë se tarifat e regjistrimit kalojnë në buxhetin e shtetit, qeveria mund të përjashtojë

ALUMNËT QË PËRFAQËSUAN SHKOLLËN NË AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Të angazhuar për përgjigjen ndaj sfidave të reja në Evropë

Dështimi për të parandaluar valën e re të populizmit, që rrezikon të sjellë në pushtet forca ekstremiste dhe një prirej drejt autoritarizmit në Hungari dhe Poloni, kanë intensifikuar shqetësimin mbi shëndetin dhe të ardhmen e demokracisë në Evropë dhe më gjerë. Në këtë situatë, roli i Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës si qendra të edukimit qytetar merr një vlerë edhe më të madhe për drejtuesit politikë të kontinentit dhe institucionet ndërkombëtare. Duke synuar analizimin e shkaqeve të këtyre problemeve të reja dhe gjetjen e rrugëdaljeve të mundshme, u zhvillua në vitin 2016 një program i ri i rrjetit të Shkollave të titulluar "Tryezat qytetare". Programi mbledhi së bashku 30 alumnë të shkollave dhe të rinj të tjerë evropianë me qëllim përgatitjen e një raporti kritik mbi problemet me të cilat përballlet sot Evropa. Ky raport iu dorëzua Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, z. Thorbjorn Jagland, si një kontribut i drejtëpërdrejtë i alumnëve të edukuar në shkollat politike. Shkolla Shqiptare u përfaqësua në këtë nismë nga alumni Admir Malaj, ekspert i politikave për çështjet e mbrojtjes sociale.



Takimi i parë i "Tryezave Qytetare" u zhvillua më 2-4 Maj në Berlin, ndërkohë që takimi i dytë do të u zhvillua në Strasburg në 16-17 qershor 2016. Mes folësve të ftuar në këto dy evente ishin: Joschka Fischer, Ivan Krastev, Grete Brochmann, Daniel Gros, Branko Milanovic, Kalypso Nicolaïdis, Claus Offe, Nathalie Tocci si dhe Gianni Buquicchio, presidenti i Komisionit të Venecias. Bazuar mbi debatet e zhvilluara përgjatë këtyre tryezave si dhe në eksperiencat e vetë alumnëve pjesëmarrës u përgatit një raport analizues mbi problemet e demokracisë në

Evropë, i cili iu dorëzua në përfundim të programit Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, z. Thorbjorn Jagland. Rekomandimet e ofruara nga personalitetet e ftuara dhe alumnët e shkollave u vlerësuan nga z. Jagland, i cili nënvizoi edhe njëherë vlerën e edukimit dhe informimit të shoqërive tona si një mjet për të parandaluar populizmin dhe autokracinë në rritje në disa vende të cilësuar më parë demokraci liberale. Ky raport dhe rekomandimet përkatëse është publikuar tashmë në rubrikën publikime të faqes online të Akademisë.



Përfshirja e komuniteteve rurale në administrimin e plazheve të Rivierës Shqiptare - Autorë z. Admir Malaj, Ervis Moçka, Oljan Kanushi

1.Rekomandohet konsultimi i vazhdueshëm me komunitetet dhe rritjen e

transparencës për sa i përket planeve zhvillimore për turizmin, ashtu si dhe hapësirave të cilat mund të jenë të përshtatshme për shfrytëzimin për stacione plazhi. Instrumenti mund të jetë aktivizimi në këtë drejtim i kryesive të fshatit dhe vetë komuniteteve bregdetare, sipas modelit të bazuar në traditë.

2. Rritja e kapaciteteve të komuniteteve bregdetare, apo përdorimi i formulave të bashkimit të operatorëve, ose krijimi i shoqatave komunitare, për të rritur shanset për marrjen në përdorim të plazheve nga vetë anëtarë të komuniteteve.



Alumni Admir Malaj në takimin e "Tryezave qytetare". Lart, raporti i përgatitur për Sekretarin e Përgjithshëm të KIE



Forumi dytë i Berlinit

Për të dytin vit radhazi Shoqata e Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës, me iniciativën e shkollës së Moskës dhe së bashku me "Robert Bosch Stiftung", organizuan forumin me temë "Në kërkim të universalizimit të humbur" në Berlin më 17-18 tetor 2016. Forumi u mbajt në selinë e "Robert Bosch Stiftung" me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 21 shkollave anëtare, së bashku me të ftuar të tjerë të rëndësishëm nga Rusia, Franca, Gjermania, Norvegjia, Suedia dhe Britania e Madhe. Shkolla shqiptare u përfaqësua në këtë Forum nga antari i bordit drejtues z. Bernard Zeneli si dhe alumnet Endri Mykaj, Keshilltar pranë zyrës së Kryeministrit; Oljan Kanushi, Koordinator pranë Këshillit të Ministrave; Gentiola Madhi, kërkuese pranë Qendrës së Ekselencës së Ministrisë së Jashtme; Elira Çanga, eksperte e medias pranë Prezencës së OSBE në

Tiranë si dhe Mimoza Koçiu, redaktore pranë ABC News TV. Diskutimet gjatë dy ditëve të eventit theksuan nevojën e zbulimit të mënyrave të reja dhe ndërveprimit mes kulturave të ndryshme për të përballuar problematikat që rrezikojnë të kthejnë pas normat e bashkëjetesës paqësore dhe respektimin e të drejtave të drejtat e njeriut, lirinë, shtetin e së drejtës dhe demokracinë. Ngjarjet e fundit në Ukrainë si dhe kriza e emigrantëve me të cilën përballlet Evropa, kërkojnë përgjigje të qarta dhe efikase nga shoqëritë tona. Pjesëmarrësit u ndalën edhe në situatën e vështirë në të cilën detyrohet të punojë së fundi shkolla politike e Moskës, si rrjedhojë e masave kontrolluese të vendosura nga qeveria ruse.

Forumi antikorrupsion i Vishegradit

Në vitin 2015 startoi zbatimin një projekt i përbashkët i Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës në vendet

e Vishegradit (V4) dhe ato të Ballkanit Perëndimor. Objektivat e programit përfshijnë identifikimin e problematikës në luftimin e korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, duke ndarë përvojat e vendeve të V4 në terren, dhe pajisjen e pjesëmarrësve të zgjedhur me eksperiencë dhe njohuri të nevojshme për përmirësimin e masave antikorrupsion në vendet e tyre. Një vizitë studimore në Ęarshavë dhe një trajnim rajonal në Beograd mbledhën së bashku alumnet të shkollave, por edhe të rinj të tjerë, të cilët aplikuan nëpërmjet thirrjes së hapur në mjetet e komunikimit të Shkollave. Rrjeti alumni i Shkollës sonë u përfaqësua në këtë program nga Arlinda Hoti, drejtore e trajnimeve në Shkollën e Administratës Publike, Florenca Korbi, menaxhere program pranë zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë si dhe Alban Fishka, drejtues i departamentit të antikorrupsionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Programi parashikon gjithashtu një seri takimesh kombëtare mbi këtë temë dhe një prej këtyre diskutimeve do të zhvillohet edhe në Tiranë në vitin 2017.



Punimi mbi prokurimet publike në Njësitë Vendore
- Autore znj. Florenca Korbi

1. Sugjerohet ngritja e një shërbimi konsulence nga Agjencia e Prokurimeve Publike për të qartësuar pyetjet apo

çështje të ndryshme të operatorëve ekonomikë, administratës vendore dhe publikut. Ky shërbim është i nevojshëm jo vetëm për zyrtarët e përfshirë në procesin e prokurimeve, por edhe për aktorët e biznesit dhe shoqërinë civile me qëllim inkurajimin e mbikqyrjes nga publiku të këtyre proceseve.

2. Kontraktimin e ekspertëve të fushës nga njësitë vendore në hartimin e specifikimeve teknike të prokurimeve. Kjo do të minimizonte problematikën e hasur në cilësi dhe rastet e ankesave për favorizim dhe paracaktim paraprak të operatorëve fitues.

Takim vjetor, këtë herë nën tingujt shkodranë

I kthyer tashmë në një traditë, takimi i tretë vjetor i rrjetit alumni të Shkollës u zhvillua më 17 dhjetor 2016. Risia e këtij viti ishte zhvillimi i tij në qytetin e Shkodrës duke e lidhur edhe me ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së re të Shkollës si dhe prezantimin e një punimi kërkimor në prezencë të aktorëve vendorë në bashkinë Shkodër.

Drejtori i Akademisë së Studimeve Politike falenderoi partnerët për mbështetjen e tyre si dhe vlerësoi angazhimin aktiv të pjesëmarrësve të Shkollës si një kontribut të rëndësishëm për mirëqeverisjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.



Së bashku me znj. Debora Kern, shefe e sektorit të demokracisë pranë ambasadës së Zvicrës si dhe nënkryetaren e bashkisë Shkodër, Znj. Emilja Koliqi, ata shpërndarë certifikatat dhe përgëzuan pjesëmarrësit për këtë moment të rëndësishëm. Dy të diplomuar, znj. Ramiola Kalemi, anëtare e këshillit bashkiak Durrës dhe z. Besfort Lamallari, kërkues i "Freedom House", përshëndetën pjesëmarrësit në këtë ceremoni në emër të gjeneratës së tyre.

Në këtë mënyrë, një grup prej 26 udhëheqësish të rinj politikë, aktivistëve civilë dhe nëpunësve publikë përfunduan me sukses ciklin njëvjeçar të studimit dhe iu bashkangjiten rrjetit të alumnëve të Shkollës. Aktiviteti vazhdoi më tej me takimin vjetor të rrjetit alumni të shkollës në një atmosferë më festive pranë restorantit "Tradita" në Shkodër, ku alumnët u ritakuan dhe ndanë arritjet dhe sfidat në përfundim të një viti të gjatë.

Kryetarja e parlamentit zviceran vlerëson diskutimin me alumnët



A është modeli i demokracisë direkte zvicerane arsyeja e konsensusit, transparencës në vendimmarrje dhe angazhimit qytetar zviceran? A mund të aplikohet kjo pjesëmarrje direkte mbi reformat kryesore dhe debatet e nxehta politike e sociale në Shqipëri, atëherë kur duket

se politikanët kanë dështuar në arritjen e konsensusit mbi reformat e rëndësishme që rrezikojnë të pengojnë rrugën e integritit evropian të vendit? Këto pyetje ishin në qendër të diskutimit të alumnëve të Shkollës me znj. Christa Markwalder, kreun e Parlamentit të Zvicrës, të zhvil-

luar në ambientet e Qendrës për Hapjen dhe Dialog, më 18 nëntor 2016. Pjesëmarrësit e Shkollës së Studimeve Politike patën gjithashtu mundësinë që të thellonin njohuritë e tyre mbi modelin e veçantë politik të Zvicrës. Një vend ku kultura, fe dhe minoritetet sociale të ndryshme kanë bashkëjetuar falë një sistemi unik politik, me theks në federalizmin, një pjesëmarrje të gjerë popullore në procesin politik, një politikë të jashtme të bazuar në neutralitet dhe politikën e brendshme të bazuar në konsensus. Znj. Markwalder vlerësoi nivelin e lartë të diskutimit dhe theksoi si shumë të rëndësishëm edukimin e programit të Shkollës, veçanërisht në këto momente kur është më e nevojshme se kurrë një udhëheqje politike. Takimet dhe shkëmbimi i pikëpamjeve me vendimmarrësit e lartë mbi çështjet aktuale të politikë-bërjes përbëjnë një pjesë të rëndësishme të programit të Shkollës.

Çfarë ka qënë për ju Shkolla e Studimeve Politike ?

Vlerësimet e disa prej alumnëve për programin e shkollës



SENIDA MESI

Anëtare e Këshillit Bashkiak dhe kandidate për deputete në Shkodër / Eksperte finance dhe kontabiliteti / Lektore pranë universitetit "Luigj Gurakuqi"

"Personalisht, shkolla më ka dhënë një shtysë për më shumë investim dhe pjesëmarrje në qeverisje, sidomos në qeverisjen vendore. Është një shkëmbim idesh dhe opinionesh me kolegë dhe lektorë profesionistë në lidhje me çështjet politike, sociale dhe të lidhshpimit në Shqipëri. Një mundësi për më shumë network dhe informacion".



ARBEN SHKODRA

Zv.president i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë

"Ne ishim brezi i parë, që shërbeu si bazë për fillimin e një tradite, e cila jo vetëm tregoi vlerat e saj duke krijuar qëndrueshmëri dhe rritje të performancës vit pas viti, por edhe ka thyer çdo pritshmëri. Ndjekja e shkollës më shërbeu për të konsoliduar njohuritë e mija dhe rezultoi një mundësi për ta parë politikën dhe politikat në një këndvështrim tjetër më interesant dhe më të qartë."



JULIANA MEMAJ

Kryetare e bashkisë së Urës Vajgurore

"Diskutimet me drejtues të tjerë të rinj që ulen së bashku në këtë program dhe vijnë me edukime dhe eksperiencë të ndryshme profesionale, shërbeu për të kuptuar më mirë problematikën e përditshme dhe gjetur përgjigjet e duhura për zgjidhjen e tyre, bazuar mbi praktikën më bashkëkohore vendase dhe ndërkombëtare."



ALUMNI NË FOKUS

EVIS SHURDHA

Kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik

“Shkolla politike është një mundësi e shkëlqyer për të njohur dhe diskutuar mbi eksperiencat më të mira vendase dhe ndërkombëtare të mirëqeverisjes dhe politikave shtetndërtuese, e gjitha kjo e sjellë në një ambjent konkurrues idesh dhe vlerash profesionale te pjesëmarrësve të perzgjedhur.”



BESFORT LAMALLARI

Këshilltar i Ministrit të Punëve të Brendshme / Kërkues

“Shkolla është një mundësi e mirë për t’u njohur me ide, përvoja, qasje dhe kontakte të reja. Seminaret dhe diskutimet e mbajtura i ofrojnë mundësinë gjithsecilit që të ndajë mendimin e tij mes pasionit dhe nevojës për të dëgjuar dhe mirëkuptuar mendimin ndryshe. Angazhimi në një projekt kërkimor të përbashkët forcon më tej këtë lidhje dhe natyrshëm rritet dhe dëshira për të kontribuar në mënyrë më aktive në politikëbërje.”



ORNELA LIPERI

Kryeredaktore e revistës ekonomike “Monitor”

“Angazhimi ishte një përvojë unike dhe shumë dimensionale. Ndërthurja e leksioneve me bisedat praktike të mundëson të shohësh politikën, politikanët dhe proceset e vendimmarrjes në një këndvështrim të ndryshëm nga më parë. Kurset shërbyen jo vetëm për thellimin në çështje të ndryshme, sipas tematikave të zgjedhura me kujdes, por edhe si një moment vetëreflektimi e krijimi njohjesh e miqësish të reja.”





JULINDA MANSAKU

Avokate Shteti, pranë Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërmintor, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit

“Një eksperience edukuese nga e cila mëson se politika nuk është profesion, por se profesionalizmi në politike mund të sjelle sisteme të suksesshme afatgjata. Një shkollë që mbështet dhe inkurajon zhvillimin e profesionistëve të rinj, duke i ftuar të jenë kontributorë në transformimin e konceptit të të bërit politikë, duke e parë atë si evolucion dijesh dhe vlerash, duke nisur pikësëpari nga vetëvetja.”

INDRIT PUTECI

Drejtor i "Value the Person Albania" / Këshilltar pranë kryetarit të bashkisë Tiranë

“Albert Einstein ka thënë se “Politika është më e vështirë se fizika.” Shkolla është një përqsje që e lehtëson ushtrimin e suksesshëm të leadership-it në arenën e politikës. Ky program përbën një avantazh unik për cilindo që dëshiron të influencojë politikën. Larmia e këndvështrimeve, rrjeti i gjerë dhe diversiteti i kontakteve, që shkolla të mundëson, janë vlera që rriten edhe pas përfundimit të saj.”



RAMIOLA KALEMI

Anëtare e Këshillit Bashkiak në Durrës / Lektore pranë universitetit "Aleksandër Moisiu"

“Së bashku me misionin e transmetimit të dijeve, Shkolla përmbushi më së miri dhe misionin e krijimit të një vendtakimi, në të cilin diversitete njerëzore, krijuan një mjedis të përbashkët vlerash si toleranca, mirëkuptimi, respekti për njëri-tjetrin. E veçanta e kësaj shkolle, qëndron pikërisht në përjetimin e kësaj eksperience unike, që jo lehtë gjendet në realitetin tonë.”



Foto familjare e takimit vjetor e rrjetit alumni. Shkodër, dhjetor 2016

Rrjeti Alumni 2007-2016

VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues

Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "Eordl Vision"
Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës hollandeze në Tiranë
Znj. Elma Teršana (Shehu)	Drejtoresha e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të Fëmijëve (UNICEF)

Z. Eltjon Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtoresha e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM

Z.	Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z.	Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj.	Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj.	Sidita Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z.	Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

VITI 2008

Znj.	Arbana Dibra	Drejtoreshë ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z.	Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora Neës" TV
Znj.	Beslinda Rrugja	Asistent avokate
Z.	Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj.	Brasena Koka	Koordinatorë projekti pranë organizatës "Eorld Vision"
Znj.	Brunilda Minaroli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj.	Edlira Gjoni	Koordinatorë projektit EU-CARDS VET të inçiniv / Gazetare
Znj.	Edlira Mali	Drejtoreshë Ekzekutive e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj.	Edlira Papavangjeli	Koordinatorë Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit
Znj.	Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës
Z.	Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj.	Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Znj.	Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z.	Erion Avllazagai	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z.	Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"

Z.	Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z.	ERVIN KARAMUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj.	EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
Z.	FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave
Znj.	GENTIANA RAMADANI	Drejtoreshë ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"
Z.	GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z.	GJOK VUKSANI	Deputet
Znj.	IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes
Z.	KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj.	KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z.	MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj.	MONIKA STAJA	Gazetare "Top Channel"
Znj.	NAHLE BEJLERI - FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z.	OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z.	REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror
Z.	REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj.	SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere e "Opportunity Albania"
Znj.	VILMA PREMTI	Drejtoreshë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z.	Adrian SHEGA	Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë
Znj.	Admira Poci	Specialiste pranë Institutit Goethe
Znj.	Albana HANA	Specialiste në Ministrinë e Integritimit

Znj.	Ana XHEKA	Drejtoreshë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Znj.	Ardita SHEHAJ	Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës
Znj.	Beti NJUMA	Gazetare, "Top Channel"
Z.	Blerim KOLA	Kryeredaktor, Nesër TV
Z.	Edvin SHVARC	Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës
Znj.	Elira CANGA	Gazetare, "Gazeta Shqiptare"
Znj.	Elsa TOSKA (DOBJANI)	Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese
Znj.	Entela HAMITI	Anëtare e Partisë Socialiste
Znj.	Erinda SHAH	Anëtare e Partisë G99
Z.	Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënies publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë
Z.	Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Genc HOXHA	Supervisor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z.	Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë
Z.	Gentian MANO	Menaxher i organizatës "Eorld Vision", Librazhd
Znj.	Gerta META	Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z.	Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integritimit
Z.	Ilir TOPI	Aktivist i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Ingrit PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"
Znj.	Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj.	Mimoza KOCIU	Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z.	Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj.	Plejada GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania

RRJETI ALUMNI 2007-2016

Z.	Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z.	Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj.	Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj.	Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z.	Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z.	Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z.	Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj.	Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top Neës" TV
Znj.	Anila Shqypi	Koordinatorë projekti, GTZ Albania
Z.	Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë
Z.	Besjan Pesha	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI
Z.	Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë e Kukës
Znj.	Blertha Gjermani	Kryeredaktore, ORA Neës TV
Z.	Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë
Znj.	Eglantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"
Z.	Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë
Znj.	Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokollit të Presidentit të Republikës
Z.	Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror
Znj.	Fatjona Mejдини	Gazetare, "Shqip"
Z.	Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës



Takimi alumni 2014, Tiranë

Z.	Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve	Znj.	Migena Nelaj	Drejtoreshë për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Znj.	Giomela Gjini	Drejtoreshë Teknikë në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave	Z.	Ols Lafe	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Z.	Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"	Znj.	Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimin në Këshillin e Ministrave
Znj.	Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins	Z.	Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Znj.	Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV	Znj.	Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Znj.	Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV	Z.	Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Znj.	Klodiana Thartori	Koordinatorë Programi "Save the Children"	Znj.	Suela Cela	Specialiste në departamenti ligjor në Ministrinë e Bujqësisë
Z.	Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave			
Znj.	Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit			
Z.	Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë			
Znj.	Migena Muhaj	Koordinatorë në programin Sësisë Partnerships in Health			

VITI 2011

Znj.	Ada Ramaj	Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm
------	-----------	--------------------------------------



Znj. Albana Veizi	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës
Z. Alvi Bajramaj	Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT
Znj. Anxhela Andoni	Aktiviste e Forumit të Gruas të Partisë Socialiste, rrethi Pogradec
Z. Arlind Lugji	Specialist në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive
Z. Arnold Hajro	Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)
Znj. Daniela Mehmeti	Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës
Znj. Enila Hasani	Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme
Z. Enio Haxhimihali	Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit
Znj. Erjola Muka	Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë

Z. Genti Çani	Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Z. Gentian Xhaxhiu	Gazetar "Shijak TV"
Znj. Gresa MARTIRI	Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë
Z. Helidon BELE	Drejtor në Tirana Bank
Z. Ilir Stojku	Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë
Znj. Klesta Hysi	Koordinatorë programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"
Z. Kreshnik Ternova	Administrator, ALK Pharma sh.p.k.
Znj. Ledi Jahja-Muçaj	Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri
Znj. Merita Mansaku-Meksi	Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim
Znj. Mirjam Reçi	Drejtoreshë ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës
Znj. Olta Blaceri	Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora Neës" TV
Z. Qamil Dika	Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD
Znj. Rajmonda Lajthia	Gazetare, "Vizion Plus" TV
Znj. Albana Shtylla	Shefe kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Znj. Alisa Demollari	Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë
Z. Altin Hoti	Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian
Z. Altin Ibro	Jurist/ Celibashi Consulting shpk
Z. Andi Seferi	Drejtuës i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri
Znj. Anisa Seferaj	Juriste/ Bashkia Tiranë

VITI 2012

Znj. Ardita Kongjonaj	Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit
Z. Arian Galdini	Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi
Znj. Baisa Sefa	Kërkuuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri
Z. Elidon Laze	Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z. Erlis Shahu	Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z. Ermal Simaku	Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste
Z. Ermir Godaj	Shërbimi i Përmbartimit, Ministria e Drejtësisë
Znj. Ervina Domi	Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
Znj. Eva Dauti	Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive
Znj. Florensa Haxhi	Koordinatorë e strategjive në Këshillin e Ministrave
Z. Fredi Guça	Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"
Z. Ilir Kondi	Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)
Z. Ilir Korbi	Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z. Ilir Mimani	Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Znj. Jorina Gjinari	Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future
Z. Ledio Braho	Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës

RRJETI ALUMNI 2007-2016

Znj. Margarita Kola	Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktivistë e partisë politike Aleanca Kuqezi (AK)
Znj. Mariola Qesaraku	Koordinatorë projekti pranë Instituti për Demokraci dhe Meditim
Znj. Marsida Çela	Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA
Znj. Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj. Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z. Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z. Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj. Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj. Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z. Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj. Suela Lala	Aktivistë në Shoqërinë Civile

VITI 2013

Znj. Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj. Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktivistë në Partinë Demokratike (PD)
Z. Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z. Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z. Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj. Blerina Doracaj	Eksperte ligjore dhe prokurimesh në Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktivistë në Partinë Socialiste (PS)

Znj. Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktivistë e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj. Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj. Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktivistë në partinë politike Aleanca Kuqezi (AK)
Znj. Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktivistë e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
Z. Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj. Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritimit/Aktivistë në Partinë Socialiste
Z. Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj. Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z. Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
Z. Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Z. Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës

Znj. Klementina Cenkollari	Gazetare, "Ora Neës" TV
Z. Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
Znj. Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj. Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktivistë e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj. Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana

VITI 2014

Znj. Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
-----------------	--

Znj. Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënieve publike pranë GIZ Albania/ Aktivistë e partisë FRD
Znj. Arselja Gjonaj	Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit
Z. Dritan Cekani	Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste
Z. Elidon Lamani	Menaxher projektsh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës"/ Aktivist i shoqërisë civile
Z. Endri Mykaj	Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave
Znj. Enisa Halili	Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë
Z. Erlis Hereni	Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"
Z. Florjan Muçaj	Nënkryetar i Bashkisë Fier/ Aktivist i Partisë Socialiste
Z. Francesko Muçaj	Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste
Znj. Ina Metko	Juriste, Ministria e Integritimit Evropian
Z. Juel Jarani	Zv.rektor në Universitetin e Sporteve
Znj. Juliana Cici	Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"
Z. Lulzim Omuri	Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike
Znj. Magji Apostoli	Koordinatorë projekti pranë "Europartners Development"
Znj. Pranvera Myrselaj	Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"
Z. Redi Saliasi	Përgjegjes i PR dhe komunikimit pranë kompanisë "Croën Agents"
Znj. Rikelda Balliu	Koordinatorë e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave

Znj. Vjollca Dako Drejtore ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"

VITI 2015

Z. Admir Malaj Këshilltar pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Znj. Amela Juka P.administratë / Political activist DP

Znj. Arlinda Hoti Drejtore e trajnimeve, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

Z. Artur Bardhi Specialist pranë Dep. Të Integritimit, Ministria e Punëve të Jashtme / Aktivist i LSI

Znj. Blerina Ago Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë

Znj. Dorina Puto Eksperte ligjore pranë Institucionit të Presidentit të Republikës

Z. Elvin Nuriu Drejtor i administratës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore / Aktivist i PDIU

Znj. Erjona Rusi Gazetare, Report TV

Erton Graceni Këshilltar për Teknologjinë pranë Këshillit të Ministrave

Z. Ervis Mocka Zv.dekan i Universitetit të Vlorës / Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë

Znj. Evis Shurdha Drejtore e Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave

Z. Fabian Zhilla Kërkues mbi krimin e organizuar / Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë

Znj. Gentiola Madhi Kërkuese pranë organizatës Shtetiëeb

Znj. Irma Kopliku Anëtare e Parlamentit / Lektore pranë Universitetit të Shkodrës

Znj. Jerina Vataj Këshilltare e LSI pranë Këshillit Bashkiak Lezhë

Znj. Jolanda Mustafaraj Këshilltare e PS pranë Këshillit Bashkiak Durrës

Znj. Lindita Pali Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak Burrel

Znj. Marsida Duli Doktoreshë / Aktiviste e PD

Znj. Mirjeta Gjongecaj Këshilltare e PD pranë Këshillit Bashkiak Bajram Curri

Z. Oljan Kanushi Koordinator pranë Këshillit të Ministrave

Z. Sofjan Jaupaj Këshilltar i Ministrit të Kulturës

Znj. Tresi Trebicka Menaxhere programesh mbi zhvillimin e qëndrueshëm pranë "Eco Partners Albania"

Znj. Valbona Mucaj Trajnuese pranë Shkollës Shqiptare e Administratës Publike

Znj. Zhanina Dapi Drejtore e drejtorisë së Integritimit, Ministria e Ekonomisë

VITI 2016

Znj. Albana Kraja Shefe e njësive së përkthimit, Parlamenti Shqiptar

Znj. Armela Mitku Anëtare e Këshillit Drejtues të FRD / Specialiste pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Tiranë

Z. Besard Buzi Ekspert vendor pranë Këshillit të Evropës

Z. Besfort Lamallari Kërkues -Autor i raportit vjetor "Freedom House"

Znj. Brikena Hoxha Asistente ekzekutive pranë bankës "Societe Generale Albania"

Znj. Eda Lika Asistente ligjore, Zyra e Kryeministrit

Znj. Edlira Osmani Kërkuese / Koordinatore pranë misionit EURALIUS

Z. Eneo Zguri Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD

Z. Eraldo Xhani Këshilltar i grupit parlamentar të PS / Kreu i Dep. Cilësisë, Posta Shqiptare

Znj. Freskida Miloti Producente dhe gazetare pranë Radio "Tirana"

Z. Indrit Puteci Këshilltar i kryetarit të bashkisë Tiranës

Znj. Juliana Memaj Kryetare e Bashkisë Ura Vajgurore

Znj. Julinda Mansaku Avokate pranë Avokaturës së Shtetit

Znj. Krisilda Fana Shefe e dep. koordinimit me institucionet dhe HR, Presidenti i Republikës

Znj. Manjola Hidri Eksperte e projekteve IPA pranë Ministrisë së Integritimit

Znj. Manushaqe Rina Lektore në Univer. e Durrësit / Këshilltare bashkiake e PD-së, Dibër

Znj. Mina Skuqi Juriste / Asistente e nënkryetarit të Parlamentit

Znj. Mirbana Bilali Drejtore ekzekutive e kompanisë "Security & Protection Group"

Znj. Olta Kepucka Shefe e Burimeve Njerëzore dhe Financave, GIZ Shqiperi

Znj. Ornela Liperi Kryeredaktore e revistës "Monitor"

Znj. Ramiola Kalemi Lektore, pranë Univ. Durrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Durrës

Znj. Romira Muka Lektore në Universitetin e Shkodrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Shkodër

Znj. Senida Mesi Eksperte kontabël / Këshilltare bashkiake e PS-së, Shkodër

Z. Vaeld Zhezha Këshilltar i ministrit të Mjedisit

Znj. Zamira Mustafaraj Inxhinierë / Këshilltare bashkiake e PS-së, Durrës

Znj. Zarie Visha Drejtoreshë shkollë / Këshilltare bashkiake e LSI-së, Kukës

* I referohet pozicionit të mbajtur gjatë periudhës së pjesëmarrjes në program



Gjenerata e parë e Shkollës së Studimeve Politike, 2007

10 VJET

SHKOLLA E STUDIMEVE POLITIKE

2007 - 2017

Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center, Tel/fax: +355 4 2272173
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, +355 4 4504788
Kati 4, Zyra 2 E-mail: info@asp.al
Tirane, Shqipëri Web: www.asp.al

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë
www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha
botimet në versionin pdf.
Skanoni këtë kod për më tej QR CODE



- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Akademia Studimeve Politike
- Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike
financohet nga Këshilli i Evropës dhe
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri si edhe
vetë kontributet e pjesëmarrësve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri